



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 1131, datë 24.12.2020

P Ë R

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.212, DATË 11.3.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT
TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT
TË OBJEKTEVE ARSIMORE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pika 2, e vendimit nr.212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, të jetë në masën 5 130 260 797 (pesë miliardë e njëqind e tridhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, nga të cilat:

- a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 4 125 706 878 (katër miliardë e njëqind e njëzet e pesë milionë e shtatëqind e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekësh pa TVSH;

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 1 004 553 919 (një miliard e katër milionë e pesëqind e pesëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë) lekësh pa TVSH.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.


K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE


MINISTRI I SHITIT
PËR RINDËRTIMIN
ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 6705/1
DATË 7.1. 2024

MINISTRIT TË SHËTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
BASHKISË TIRANË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI

